



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 22/ 01 / 2024

VENDIM

Nr. 1, datë 22/01/2024

PËR

PLANET E GADISHMËRISË NË RASTET E EMERGJENCAVE CIVILE PËR DIGAT E MËDHA TË SHFRYTËZUARA NGA BASHKIA DIMAL

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 22.01.2024 mori në shqyrtim Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për 7 digat e mëdha të Allambrez, Malthikë, Gorican i ri, Gorican i vjetër, Manastir, Protoduar, Slanicë që shfrytëzohen nga Bashkia Dimal.

Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për 7 digat e mëdha të përgatitur nga specialistët e Bashkisë Dimal të dorëzuara pranë KKDM rezultojnë se janë përgatitur në përgjithësi në përputhje me kërkesat e KKDM për hartimin e këtyre planeve të dhëna në Vendimin e KKDM Nr. 5, dt.16.11.2020.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM të miratoj Planet e emergjencave civile të paraqitur nga Bashkia Dimal. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

1. Të miratoj Planet e Gadishmërisë për rastet e emergjencave civile të 7 digave të mëdha që shfrytëzohen dhe administrohen nga Bashkia Dimal sic janë: Allambrez, Malthikë, Gorican i ri, Gorican i vjetër, Manastir, Protoduar dhe Slanicë
2. Ti kërkoj Bashkisë Dimal:
 - Përgatitjen e hartave të përmbytyjeve dhe përcaktimin e zonave me rrisht të lartë në rastet e prurjeve maksimale të ujit me përsëritje një herë në 100 vjet, 1 herë në 1000 vjet dhe në rast të prishjes së mundshme të ndonjë prej këtyre digave
 - Përgatitjen e projekteve për Instalimin e sistemeve të Alarmit në digat e mëdha të Allambrez dhe Gorican i ri që janë me rrisht të lartë për humbjen e jeteve të njerëzve në zonat urbane poshtë tyre në rast të prurjeve të mëdha apo prishjes së mundshme të digës

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

